



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 2627 prot.

Tiranë, më 20/05/2020

URDHËR

Nr. 333, datë 20.05.2020

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK
PËR

“MASAT NDAJ COVID-19 QË DUHET TË NDËRMARRIN INSTITUCIONET E
KOPSHTeve DHE ÇERDHEVE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infekzioni COVID-19,

URDHËR:

1. Miratimin e Udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet e kopshteve dhe çerdheve”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe organet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 543/ Prot.

Tiranë, më 14.05. 2020

UDHËZUES

PËR

“MASAT NDAJ COVID-19 QË DUHET TË NDËRMARRIN INSTITUCIONET E KOPSHTeve DHE ÇERDHEVE”

PËR FËMIJËT E KOPSHTeve DHE ÇERDHEVE

A - Sjellja dhe marrja e fëmijëve nga institucioni (çerdhe, kopësht)

- Orari për sjelljen dhe marrjen e fëmijëve në këto institucione rregullohet sipas një grafiku të hartuar nga drejt e institucionit dhe të monitoruar nga edukatoret.
- Në hyrje dhe në dalje të institucionit të vendoset një higjenizues për duart në trajtë solucioni me përbajtje aktive të alkoolit 60% i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm, në mënyrë që fëmijët të pastrojnë duart kur vijnë dhe kur ikin.
- Prindërit duhet të sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikmëri në orarin e përcaktuar.
- Fëmija shoqërohet nga njëri prind, i cili qëndron jashtë ambienteve të institucionit dhe pret në distancë 1.5 m nga prindërit e tjerë për ta dorëzuar fëmijën tek personeli i çerdhes/ kopështit.
- Gjithmonë fëmija të pritet dhe shoqërohet brenda institucionit nga një edukatore e cila e merr fëmijën në hyrje të kopshtit/çerdhes.
- Drejtuesi i institucionit duhet të caktojë një person i cili në momentin kur fëmija hyn në institucion të kryejë çdo ditë:
 - Matjen e temperaturës me termometër digjital.
 - Pastrimin e duarve të fëmijës me solucionin higjenizues në momentin që hyn në çerdhe/kopësht.

- Nëse është e mundur të vendosen vaska me solucion dezinfektues me bazë klori aktiv, për dezifikimin e shuajve të këpucëve përpara hyrjes në ambientet e brendshme të çerdhes/kopështit.
- Fëmija lejohet të hyjë dhe të dalë nga institucioni vetëm në mbërritje dhe në ikje.
- Rekomandohet që sjellja apo marrja e fëmijëve nga çerdhja/kopështi të bëhet nga prindi dhe jo nga gjyshërit.
- Dera e institucionit do të qëndrojë e myllur gjatë kohës që fëmijët janë brenda, ndërsa dritaret e sallave të hapen herë pas here për të lejuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre. Ambjenti duhet te jete i ajrosur gjatë gjithë kohës.
- Në rast se fëmija shfaq temperaturë, prindi duhet të informojë menjëherë edukatoret dhe të mbajë fëmijën në shtëpi.
- Nëse fëmija shfaq temperaturë apo shenja të tjera të shëndetit jo të mire, njoftohet prindi që të paraqitet për të marrë fëmijën sa më pare nga ambjentet e kopshtit/çerdhes.

B - Strategjitet e distancimit shoqëror gjatë qëndrimit në kopësht/çerdhe

- Rekomandohet shfrytëzimi maksimal i ambienteve të institucionit, për të ruajtur distancimin fizik në grupet me numër të madh të fëmijëve.
- Fëmijet e një grupei duhet të qëndrojnë në të njëjtën sallë/dhomë çdo ditë dhe me të njëjtën edukatore.
- Rekomandohet të mos kryhet asnjë aktivitet jashtë ambienteve të kopshtit.
- Gjatë procesit mësimor, edukatoret qëndrojnë duke respektuar distancën dhe rekomandohet të përpilen t'i vendosin fëmijët në distancë nga njëri tjetri (p.sh. rrëth një tavolinë me 10 karrige ulen 5 fëmijë).
- Të merren masat e nevojshme që fëmijët të mos ndihmojnë në perhapjen e transmetimit të virusit duke:
 - Mbajtur secilin grup fëmijësh në një dhomë/sallë të veçantë.
 - Kufizuar përzierjen e fëmijëve midis grupeve, në kohën që ata kryejnë aktivitete te tillë si lojra ne oborr, duke hartuar një grafik sipas grupeve për këto aktivitete.
 - Lojrat me njëri tjetrin, apo aktivitete të tjera, duhet të organizohen në mënyrë që të respektohet gjithmonë brenda mundësive distancimi fizik midis fëmijëve.
 - Në kohën e gjumit të shfrytëzohet hapësira e dhomës maksimalisht duke i vendosur fëmijët larg nga njëri tjetrit.

- Rekomandohet të mos organizohen festa ditëlindjesh të fëmijëve në kopësht.

Kujdesi në mjetet e kopështit/çerdhes

A - Kujdesi për higjenën

- Fëmijët duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë institucionit, nëpërmjet mesazheve të dhëna nga edukatorja.
- Fëmijëve duhet tu flitet në mënyrë të vazhdueshme për COVID-19, rregullat e higjenës, larjen e duarve, mënyrën e duhur të kollitjes dhe teshtitjes.
- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.
- Në ambientet e institucionit të afishohen postera mbi masat e parandalimit të infektimit me COVID-19, higjenën respiratore dhe atë personale si dhe rregullat për distancimin fizik, të dizenjuara në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme nga fëmijët.
- Çdo fëmijë duhet të nxitet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës etj.
- Duhet të sigurohen: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngët, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përbajtje alkooli 60%, në ambientet e institucionit.
- Të kryhet dezinfektimi i çdo dhoma, çdo ditë. Pas largimit të fëmijëve, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lënde dezinfektuese.
- Në fund të çdo dite duhet të kryhet edhe dezinfektimi i mjediseve të përbashkëta.

Pastrimi dhe dezinfektimi i lodrave

- Lodrat të cilat nuk mund të dezinfektohen nuk duhet të përdoren.
- Lodrat apo objektet që futen në gojë dhe që janë të ndotur me sekrecione duhet të largohen dhe të mos përdoren deri sa të dezinfektohen.
- Lodrat prej rrobe që mund të lahen në lavanderi duhet të përdoren vetëm nga një fëmijë dhe më pas të lahen, përpala se të përdoren nga një fëmijë tjetër.
- Lodrat apo mjetet didaktike nuk duhet të kalohen nga një grup (klasë) në tjetrën pa i larë më parë apo dezinfektuar ato.

- Librat e fëmijëve, si dhe materialet e tjera me bazë letre, si letra, zarf, revista, dosje nuk konsiderohen se përbëjnë një rrezik të lartë për transmetim dhe nuk kanë nevojë për procedura shtesë të pastrimit ose dezinfektimit.

Kujdesi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël

Ndërrimi i pampersit

Kur ndërrohet një fëmijë, më parë duhen larë duart, më pas duhen përdorur doreza për të vijuar me ndërrimin.

B - Për Edukatorët

- Stafi mjekësor i institucionit ose personeli i institucionit i caktuar nga drejtuesi dhe i trajnuar për veprimet e mëposhtme, kryen për çdo fëmijë procedurën si vijon:
 - Mat temperaturën me termometër digital për të gjithë fëmijët si edhe për të gjithë stafin e kopshtit/çerdhes.
 - Spërkat dezinfektues me me përbajtje alkooli 60% në duart e fëmijëve dhe të stafit.
 - Vëren gjëndjen shëndetësore të fëmijëve si edhe ruajtjen e masave higjeno-sanitare prej tyre.
- Gjatë kohë që edukatorja qëndron me fëmijët duhet të përpinqet të respektojë distancimin social duke i orientuar ata në vendet ku duhet të qëndrojnë.

C - Për personelin ndihmës

- Drejtuesi i institucionit duhet të hartoje një grafik me oraret për pastimin dhe dezifikimin e institucionit.
- Rekomandohet pastrimi në mënyrë rutinë i sipërfaqeve dhe objekteve të cilat preken më shpesh nga fëmijët, veçanërisht lodrat, karrigjet, tavolinat, kutitë e lodrave, etj.
- Pastrimi i ketyre objekteve nuk duhet kryer në prani të fëmijëve në dhomë/ambient.
- Korridoret dhe tualetet pastrohen dhe dezifikohen rregullisht sipas një grafiku.
- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat.
- Largimi nga institucioni bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezifikimit të çdo ambienti të tij.

- Kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social me fëmijët dhe edukatorët dhe stafin.

Përgatitja e ushqimit dhe shërbimi i tij

A - Punonjësit e kuzhinës

- Personeli që përgatit ushqimin duhet të mbajë gjithmonë maskë.
- Personeli duhet të lajë gjithmonë duart para, gjatë dhe pas mbarimit të përgatitjes së ushqimit.
- Mjetet dhe sipërfaqet që përdoren për përgatitjen e ushqimit duhet të lahen para dhe pas përdorimit të tyre.
- Lavamanet që perdoren për larjen dhe përgatitjen e ushqimit nuk duhet të përdoren për asgjë tjeter.
- Mjedisi ku kryhet ushqyerja e fëmijëve duhet të pastrohet dhe dezinfektohet para dhe pas ngrënies së çdo grapi të fëmijëve.
- Edukatoret duhet të sigurohen që fëmijët t'i lajnë duart gjithmonë para dhe pas ngrënies, ose t'u pastrohen herë pas here (për fëmijët e cerdheve).
- Edukatoret duhet t'i lajnë duart gjithmonë para përgatitjes së ushqimit si dhe pasi i ndihmojnë fëmijët për të ngrënë.

PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek edukatorja, këtë rregullore.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjëndjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të edukatores.
- Në rast nevoje për komunikim me edukatoren apo drejtuesin përdoret vetëm komunikimi elektronik.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës në institucion, prindi nuk duhet të hyjë në mjediset e brendshme për asnjë arsyе.
- Prindi duhet të deklarojë nëse ka patur kontakt me persona të prekur me COVID-19 në familje apo në ambjentet e punës.
- Në rast se fëmija shfaq temperaturë apo simptoma të tjera të shëndetit jo të mirë, prindi duhet të paraqitet menjëherë për të marrë fëmijën.

PËR DREJTUESIT

- Të sigurojnë pajisjen e stafit me mjetet mbrojtëse, si: maska, doreza, solucione dezinfektuese.
- Për çdo fëmijë i cili paraqet probleme shëndetësore si rritje të temperatures, të konstatuar në ambientet e institucionit apo të njoftuar nga prindi, ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë, apo ka patur kontakte me persona të prekur nga COVID-19, drejtiesi lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJ.V.K.SH) dhe strukturën përkatëse për këtë njësi.
- Për çdo edukatore apo personel tjetër të institucionit, i cili paraqet probleme shëndetësore, si psh. rritje të temperaturës, etj., apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, drejtiesi lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJ.V.K.SH) dhe strukturën përkatëse në këtë njësi.

Shënim: Ky Udhëzues mund të ndryshojë në varësi të nevojave të lidhura direkt me ndryshimin e situatës epidemiologjike në vend.

DREJTOR
Albanë FICO

